

UJI

M.B.U.M.K
Nr.Prot. 1088
Datë 31/08/2011



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRI

Nr. 4149 Prot.

Tiranë, më 29.08.2011

URDHËR

Nr. 266 datë 29.08.2011

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR INDUSTRIALIZIMIN DHE TREGËTIMIN E UJRAVE MINERALE
NATYRALE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008, “Për Ushqimin”, nenit 95 të ligjit nr. 9590, datë 27.07.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 05.07.2006, “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për industrializimin dhe tregëtimin e ujrave minerale natyrale”, bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
GENC RULLI

RREGULLORE
PËR
INDUSTRIALIZIMIN DHE TREGËTIMIN
E UJRAVE MINERALE NATYRALE

1. Kjo rregullore përcakton kushtet që plotësojnë ujrat minerale natyrale të industrializuara, të prodhuara në vend ose të importuara, që përdoren për konsum njerëzor.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:
 - a) ujrat që janë produkte mjekësore;
 - b) ujrat minerale natyrale të stabilimenteve termale dhe hidrotermale.
3. Uji mineral natyral nënkupton, ujë të pastër dhe të shëndetshëm nga pikëpamja mikrobiologjike, me origjinë nga një pus ose shtresë nëntokësore dhe që nxirret nga toka nëpërmjet një ose më shumë daljeve natyrore ose puseve të shpuara.
4. Uji mineral natyral dallohet dukshëm nga uji i pijshëm i zakonshëm nga:
 - a) natyra e tij, e cila karakterizohet nga përmbajtja e elementeve minerale, oligoelementeve ose përbërësve të tjerë dhe / ose efekteve të caktuara;
 - b) pastërtia e tij origjinale.
5. Karakteristikat e përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të cilat i japin ujit mineral natyral veti të dobishme për shëndetin, vlerësohen sipas kritereve të përcaktuara në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje, me anë të metodave shkencore të njohura, të para në këndvështrimin:
 - a) gjeologjik dhe hidrogjeologjik;
 - b) fizik, kimik dhe fiziko-kimik;
 - c) mikrobiologjik;
 - d) dhe, nëse është e nevojshme, farmakologjik, fiziologjik dhe klinik (në rastin kur uji përmban, në burim ose pas ambalazhimit, jo më pak se 1000 mg/l lëndë të thata ose jo më pak se 250 mg/l gaz karbonik të lirë).
6. Përbërja, temperatura dhe karakteristikat e tjera thelbësore të ujit mineral natyral duhet të mbeten të qëndrueshme brenda limiteve të luhatjeve natyrore.
7. Burimet e ujrave minerale natyrale mund të shfrytëzohen dhe ujrat e tyre ambalazhohen vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) Industrializimi i një burimi të ujit mineral natyral duhet të bëhet pas liçensimit, sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe liçencat dhe kur vërtetohet se uji plotëson kërkesat e pikave 3, 4, 5, e 6 të kësaj rregulloreje.
 - b) Pajisjet për industrializimin e ujit duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të shmangët çdo mundësi ndotjeje dhe të ruhen vetitë që uji zotëron që në burim dhe konkretisht:
 - i) burimi ose dalja e ujit të mbrohen nga rreziku i ndotjes;


- ii) depozitat, tubacionet dhe rezervuaret të ndërtohen prej materialesh të tilla, që të parandalojnë çdo ndryshim kimik, fiziko-kimik ose mikrobiologjik të tij;
 - iii) pajisjet e larjes dhe të ambalazhimit të plotësojnë kërkesat higjienike;
 - iv) ndalohet transporti i ujit mineral natyral për të konsumatori i fundit ose nga burimi te impianti i ambalazhimit në tanke të tjerë përveç atyre të autorizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
- c) Kur gjatë industrializimit konstatohet se uji është ndotur dhe nuk ka më karakteristikat mikrobiologjike të përcaktuara në pikat 13, 14 të kësaj rregulloreje, operatori është i detyruar të pezullojë të gjitha veprimet derisa shkak i ndotjes të shmanget plotësisht dhe uji të plotësojë këto karakteristika.
8. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, kryen kontrole periodike për të vlerësuar nëse uji mineral natyral plotëson kërkesat e pikave 3,4,5, 6 dhe 7, shkronjat “b” dhe “c”, të kësaj rregulloreje.
9. Uji mineral natyral i nënshtrohet trajtimit për:
- a) Ndarjen e elementeve të paqëndrueshëm, siç janë komponimet e hekurit dhe sqfurit, me anë të filtrimit ose dekantimit, i cili paraprihet me ajrim, për sa kohë ky përpunim nuk ndryshon përbërjen e ujit në lidhje me përbërësit thelbësorë që i japin vetitë karakteristike;
 - b) Ndarjen e komponimeve të hekurit, manganit sqfurit dhe arsenikut me anë të trajtimit me ajër të pasuruar me ozon, për sa kohë ky përpunim nuk ndryshon përbërjen e ujit në lidhje me përbërësit thelbësorë që i japin vetitë karakteristike, dhe me kusht që:
 - i. trajtimi të jetë në përputhje me kërkesat e sigurisë ushqimore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ushqimin;
 - ii. të njoftohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit që kontrollon këtë trajtim.
 - c) Ndarjen e përbërësve të padëshirueshëm përveç atyre të specifikuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, për sa kohë ky përpunim nuk ndryshon përbërjen e ujit në lidhje me përbërësit thelbësorë që i japin vetitë karakteristike, dhe me kusht që:
 - i. trajtimi të jetë në përputhje me kërkesat e sigurisë ushqimore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ushqimin;
 - ii. të njoftohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit që kontrollon këtë trajtim.
 - d) Largimin e pjesëshëm ose të plotë të gazit karbonik të lirë vetëm me metoda fizike.
10. Pavarësisht kërkesave të pikës 9, ujrat minerale natyrale mund të përdoren për prodhimin e pijeve freskuese.
11. Uji mineral natyral, në gjendjen e tij në burim, i nënshtrohet edhe shtimit ose rishtimit të gazit karbonik, sipas shtojcës 2 të kësaj rregulloreje.
12. Ndalohet çdo trajtim për dizinfektim për shtimin e lëndëve bakteriostatike ose ndonjë trajtim i ngjashëm që ndryshon karakteristikat natyrale të ujit.
13. Ngarkesa e përgjithshme mikrobiologjike për ujin mineral natyral në burim, të jetë në përputhje me ngarkesën e tij normale, që tregon mbrojtjen e burimit nga të gjithë ndotësit.

Normat për ngarkesën e përgjithshme mikrobiologjike përcaktohen në shtojcën 1, pika 3.2 të kësaj rregulloreje.

14. Uji mineral natyral, në burim dhe gjatë tregëtimit, nuk duhet të përmbajë:
- Parazitë dhe mikroorganizma patogjene;
 - Escherichia coli, coliforme të tjerë dhe streptokoke fekale në 250 ml mostër të analizuar;
 - Anaerobe sporogjene sulfito-reduktues në çdo 50 ml mostër të analizuar;
 - Pseudomonas aeruginosa në 250 ml mostër të analizuar.
15. Çdo njësi ambalazhi e përdorur për ambalazhimin e ujit mineral natyral të jetë me mbyllje të përshtatshme, për të shmangur çdo mundësi fallsifikimi ose ndotjeje.
16. Mbi ambalazh të shënohet “ujë mineral natyral” ose, në rast të ujit me gaz të shënohet “ujë mineral natyral, me gaz nga burimi” ose “ujë mineral, natyral i përforcuar me gaz nga burimi” ose “ujë mineral natyral i gazuar”.
17. Në rast se uji i është nënshtruar trajtimit sipas pikës 9, shkronja “d”, shtohet shënimi “plotësisht i degazuar” ose “pjesërisht i degazuar”.
18. Etiketa për ujin mineral natyral, përveç sa parashikohet në legjislacionin në fuqi për ushqimin, duhet të përmbajë edhe kërkesat e mëposhtme:
- a) përbërësit analitikë, me karakteristikat e përcaktuara nga një laborator i autorizuar;
 - b) emrin e burimit dhe vendndodhjen e tij;
 - c) informacionin për trajtimet e nënshtruara sipas pikës 9, shkronjat “b” dhe “c”.
19. Ndalohet tregtimi i ujit mineral natyral, i të njëjtit burim me më shumë se një emërtim tregtar.
20. Kur etiketat përmbajnë një emërtim tregtar tjetër nga emri i burimit ose i vendit të shfrytëzimit, atëherë këta të fundit shënohen me shkronja të paktën një herë e gjysëm më të mëdha se shkronja e përdorur për emërtimin tregtar. *emri i burimit me shkronja 1,5 x ose më shumë se tregtar*
21. Ndalohet përdorimi i shenjave të veçanta, shënimeve, emrave të pronësisë, markave tregtare, markave të fabrikës, ilustrimeve ose shenjave të tjera simbolike ose jo, në etiketa dhe reklama në rastet kur:
- Sugjerohet një karakteristikë që uji nuk e ka, veçanërisht përsa i përket origjinës, datës së autorizuar për shfrytëzimin e tij, rezultateve të analizave ose të dhëna të tjera që lidhen me autenticitetin;
 - Në ujrat e pijshëm, të ambalazuara, që nuk janë në përputhje me pikat 3, 4, 5, dhe 6 të kësaj rregulloreje, shkaktohet konfuzion me ujin mineral natyral, veçanërisht nga shënimi “ujë mineral”.
22. Treguesit e përcaktuar në shtojcën 3, lejohen të shënohen në etiketë, në qoftë se plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë shtojcë dhe janë vertetuar nga laboratorët e autorizuar me anë të metodave shkencore të njohura, ku përfshihen analizat fiziko -

kimike dhe kur është e nevojshme analizat farmakologjike, fiziologjike dhe egzaminimet klinike, të përcaktuara në pikën 5 të kësaj rregulloreje.

23. Ndalohet shënimi në etiketë i treguesve që kanë të bëjnë me vetitë parandaluese dhe kuruese të ujrave minerale natyrale për sëmundje njerëzore.
24. Termi “ujë burimi”, përdoret për ujin mineral natyral që përdoret për konsum njerëzor në gjendjen natyrale të tij dhe ambalazhohet në burim, dhe i cili:
- a) plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 7, të kësaj rregulloreje;
 - b) plotëson kërkesat mikrobiologjike të përcaktuara në pikat 13 dhe 14;
 - c) plotëson kërkesat e etiketimit të përcaktuara në pikat 18 shkronjat “b” dhe “c”, 19, 20;
 - d) nuk i është nënshtruar ndonjë trajtimi, përveç atyre të përcaktuar në pikat 9, 11 dhe 12.
25. Uji mineral natyral, përveç karakteristikave të veçanta duhet të plotësojë edhe normat e përgjithëshme të cilësisë së ujit të pijshëm.
26. Marrja e mostrave dhe analizat fiziko – kimike e mikrobiologjike për ujin mineral natyral të bëhen sipas metodave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ushqimin.



SHTOJCA 1

KRITERE DHE KËRKESA PËR UJËRAT MINERALE NATYRALE

1. KËRKESA GJEOLGJIKE DHE HIDROGJEOLGJIKE

- 1.1 Vendosja e kuzakthe e ujembledhesit, duke shenuar lartesine e tij ne nje hartë me nje shkallë jo më të vogël se 1:1000;
- 1.2 Nje raport i detajuar gjeologjik mbi origjinën dhe natyrën e terrenit;
- 1.3 Shtirja hidrogeologjike e shtresave;
- 1.4 Nje përshkrim i operacioneve ujëmbledhëse;
- 1.5 Ndarja e zonave ose detaje të tjera, mbi marrjen e masave për mbrojtjen e burimit nga ndotja.

2. KËRKESA FIZIKE, KIMIKE E FIZIKO-KIMIKE

- 2.1 Shkalla e qarkullimit të burimit;
- 2.2 Temperatura e ujit të burimit dhe temperatura e ambientit;
- 2.3 Marrëdhëniet ndërmjet natyrës së terrenit dhe natyrës e tipit të mineraleve në ujë;
- 2.4 Mbetja e thatë në temperaturën 180 ° C dhe 260° C;
- 2.5 Përcjellshmëria elektrike ose rezistenca , matur në temperatura të specifikuar;
- 2.6 Përqëndrimi i joneve hidrogjen (pH);
- 2.7 Anionet dhe kationet;
- 2.8 Elementet jo-jonizues;
- 2.9 Elementet gjurmë;
- 2.10 Vetite radio-aktive të burimit;
- 2.11 Nivelet relative të izotopeve të elementëve përbërës të ujit, oksigjenit (16 O - 18 O) dhe hidrogjenit (protium, deuterium, tritium);
- 2.12 Toksiciteti i disa elementëve përbërës të ujit, duke marrë parasysh normat e vendosura për secilin prej tyre.

3. KËRKESA MIKROBIOLOGJIKE

- 3.1 Analizat mikrobiologjike të demonstrojnë:
 - mungesën e plotë të **parazitëve** si dhe **mikroorganizmave patogjenë**;
 - mungesën e **escherichia coli** dhe **coliformeve** të tjerë në 250 ml. në 37°C dhe 44.5°C;
 - mungesën e **streptokokeve fekale** në 250 ml;
 - mungesën e **anaerobeve sporogjene sulfito-reduktues** në 50 ml;
 - mungesën e **pseudomonas aeruginosa** në 250 ml ujë të egzaminuar
- 3.2 Ngarkesa e përgjithshme mikrobiale nuk duhet të kalojë:
 - 3.2.1 Në ujin e ambalazhuar
 - 100 për ml në 20-22° C për 72 orë në agar-agar ose agar-xhelatine;

○ 20 për ml në 37° C për 24 orë në agar-agar.

3.2.2 Në burim:

○ 20 për ml në 20-22°C për 72 orë në agar-agar ose agar-xhelatine;

○ 5 për ml në 37° për 24 orë në agar-agar.

3.3 Analiza mikrobiologjike e ujit mineral natyral në burim dhe të ambalazhuar bëhet jo më vonë se 12 orë dhe me kushte të ruajtjes së kampionit në temperaturë jo më të lartë se 4° C ±1.

4. KËRKESA KLINIKE E FARMAKOLOGJIKE

Analizat, të cilat kryhen në përputhje me metoda shkencore të njohura, të vertetojnë karakteristika të vecanta të ujit natyral mineral dhe efektet e tij në organizimin e njeriut, të tilla si diuretia, funksionet gastrite dhe intestinale, kompesimin e deficiencave në elemente minerale etj.

SHTOJCA 2


KLASIFIKIMI SUPLEMENTAR NË LIDHJE ME GAZIFIKIMIN E UJRAVE MINERALE NATYRALE

Në burim ose mbas ambalazhimit, bulëzimi i ujrave minerale natyrale në kushte normale temperature dhe presioni, jep spontanisht dhe në mënyrë të qartë vizive përmbajtjen e gazit karbonik. Në vartësi të bulëzimit dhe origjinës së gazit karbonik, ujjat klasifikohen në tre kategori si më poshtë:

1. **“ujë mineral natyral, me gaz nga burimi”**, nënkupton ujin i cili përmban dioksid karboni edhe pas dekantimit dhe e ruan atë dhe pas ambalazhimit, duke pasur parasysh rishtimin (në qoftëse është e nevojshme) të një sasive dioksidi karboni ekuivalente me atë të përftuar nga i njëjti burim uji ose pusi, i çliruar gjatë operacioneve të mësipërme dhe që është subjekt i tolerancave teknike të zakonshme.
2. **“ujë mineral natyral, përforcuar me gaz nga burimi”**, nënkupton ujin i cili pas dekantimit dhe ambalazhimit ka një përmbajtje gazi më të madhe se në burim ose pus. Gazi i shtuar ka origjinë nga burimi.
3. **“ujë mineral natyral i gazuar”**, nënkupton ujin të cilit i është shtuar dioksid karboni me origjinë tjetër nga burimi ose pusi, nga i cili rrjedh.

SHTOJCA 3

TREGUESIT DHE KRITERET E PËRCAKTUARA NË PIKËN 23

TREGUESIT	KRITERET
Ujë mineral natyral me përmbajtje shumë të ulët të kripërave minerale,	Përmbajtja e kripërave minerale jo më shumë se 50 mg./l
Ujë mineral natyral me përmbajtje të ulët të kripërave minerale,	Përmbajtja e kripërave minerale jo më shumë se 500 mg./l
Ujë mineral natyral me përmbajtje të lartë të kripërave minerale,	Përmbajtja e kripërave minerale më shumë se 1500 mg./l.
Përmban Bikarbonate,	Përmbajtja e bikarbonateve, më shumë se 600 mg./l
Përmban Sulfate,	Përmbajtja e sulfateve, më shumë se 200 mg./l
Përmban Klorure	Përmbajtja e klorureve, më shumë se 200 mg./l
Përmban Kalcium,	Përmbajtja e kalciumit, më shumë se 150 mg./l
Përmban Magnez,	Përmbajtja e magnezit, më shumë se 50 mg./l
Përmban Fluor	Përmbajtja e fluorit, më shumë se 1 mg./l
Përmban Hekur bivalent	Përmbajtja e hekurit bivalent, më shumë se 1 mg./l
Përmban Natrium	Përmbajtja e natriumit, më shumë se 200 mg./l
I përshtatshëm për personat me dietë me përmbajtje të ulët natriumi	Përmbajtja e natriumit më pak se 20 mg./l
Acid 	Përmbajtja e gazit karbonik të lirë, më shumë se 250 mg./l

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

KARTELE SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Shënim!

Dërgues: Z. Genc Puli, Ministër (MBUMK)

Nr 266 Prot. (i derguesit) Datë 29/08/2011 Nr. 1088 Prot. (hyres) Datë 31/08/2011

Lënda: Udhëz. Nr. 266 dt 29.08.2011 për miratimin e rregullores
"Për industrializimin dhe tregëtimin e ujave minerale
natyrore"

I dorëzohet:

Drejtor i Përgjithshëm

Drejtor

Përgjegjës Sektori

Për t'u trajtuar nga:

Ing. Struga; J. Kthupi

Shënim:

Të informohen drejtorit rajonale

Date

31/08/2011

Afati normal (10 ditë)

Me Prioritet (5 ditë)

Urgjent (brënda dites)

Marrë në dorëzim

Date

Praktika e përpunuar nga:

Date

Dorëzuar Eprorit përkates

Date

Përgjigja kthehet nga:

Date

Shënim:

Date